

JANAR 2023 | Nr. 23

BULETINI MUJOR INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NËNSHKRUAN MARRËVESHJE
BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN E VLORËS**





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN E VLORËS

Vlorë, më 27 Janar 2023

Ndërgjegjësimi i publikut dhe rritja e transparencës mbi misionin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Zyrës së ILD-së, si një dimension i rëndësishëm pune, u materializuan përmes një memorandumi bashkëpunimi të nënshkruar nga Inspektori

i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani dhe Rektori i Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, z. Roland Zisi.

Memorandumi parashikon disa mënyra bashkëpunimi, që nga leksionet e hapura, tek projektet e përbashkëta, që kanë në fokus edukimin ligjor dhe profesional, e





deri tek mundësia që studentët e Departamentit të Drejtësisë të zhvillojnë praktikën pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani tha se institucioni që drejton ka gjithë vëmendjen për të mbështetur rritjen profesionale të brezit të ri të profesionistëve të drejtësisë, si një kontribut konkret për demokratizimin e

shoqërisë e konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Nga ana e tij rektori z. Roland Zisi vlerësoi bashkëpunimin e vendosur me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si një mënyrë konkrete për shfrytëzimin e kapaciteteve të përbashkëta në mbështetje të programeve edukuese që i shërbejnë komunitetit të studentëve.





Më tej, sipas ftesës së rektorit Zisi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbajti një leksion të hapur me studentë e pedagogë të departamentit të drejtësisë me temë: “Roli i ILD-së në arkitekturën e re të sistemit të drejtësisë”.

Në nisje të leksionit, rektori z. Roland Zisi dhe drejtuesi i Departamentit të Drejtësisë, z. Erjon Hitaj, vlerësuan praninë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Universitetin e Vlorës me studentët e drejtësisë dhe rolin e institucionit në

monitorimin e punës së magistratëve të të gjitha niveleve.

Në përgjigje të interesimit të auditorit për pritshmëritë ndaj reformës në drejtësi, z. Metani tha se është tejet e rëndësishme, që reforma në drejtësi të prodhojë frymën, për të cilën ajo u ideua dhe u miratua.

“E mbështetur tek parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, reforma në drejtësi ka nevojë, që sot të transmetojë tek qytetarët, tek shoqëria, rëndësinë e

Në përgjigje të interesimit të auditorit për pritshmëritë ndaj reformës në drejtësi, z. Metani tha se është tejet e rëndësishme, që reforma në drejtësi të prodhojë frymën, për të cilën ajo u ideua dhe u miratua.



zbatimit të këtij parimi. Jo si një mjet për t'iu shmangur përgjegjësive, por si i vetmi standard, që na garanton të ardhmen e pavarësisë së sistemit të drejtësisë, e për rrjedhojë dhe të suksesit të shtetit të së drejtës në Shqipëri. E në këtë drejtim, funksionimi i sistemit llogaridhënës mbetet thelbësor dhe ai duhet të funksionojë tërësisht, në mënyrë

permanente dhe me konsistencë” tha z. Metani.

Bashkëpunimi konkret me fakultetet e drejtësisë së universiteteve është një synim i bërë publik nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që do vijojë edhe në universitete të tjera të vendit.





DREJTËSIA NUK MUND TË VENDOSJET APO PËRMIRËSOHET ME DEKLARATA, POR ME AKTE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani ka dhënë një intervistë për gazetarët Denis Minga dhe Lorenc Vangjeli në emisionin “Kontrast” në Report TV, mbi punën dhe sfidat e institucionit që drejton, në këto tri vite të para të funksionimit të tij.

I pyetur se si është bilanci me premtimin e parë publik, që në marrje të detyrës, për fenomenin e lirimeve para kohe të personave të dënuar me burgim të përjetshëm, z. Metani tha se e konsideron një mision të kryer, për vendosjen e standardit dhe kujdesit që magjistratët duhet të tregojnë për këtë institut, çka është konfirmuar edhe nga KLGJ, KLP e KPA.

“Në atë kohë, me të drejtë e evidentoi zoti Vangjeli, ishte fenomen shqetësues nëpër gjykata dhe prokurori, apo dhe në mjedisin

politik, publik dhe mediatik të kohës. Unë mendoj që kjo do ishte ndërhyrja e parë e rëndësishme e Inspektorit të lartë të Drejtësisë.

Sot jam shumë optimist për punën e kryer, krenar për punën e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sepse puna e tyre, jo vetëm që përballoi këtë presion, për të cilin thashë, por gjeti balancën e duhur midis këtij presioni, por edhe kontrollit të punës së prokurorisë dhe gjykatave. Ky kontroll, kjo procedurë e ndjekur nga Inspektori i lartë i drejtësisë është konfirmuar tashmë edhe nga Këshillat, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për gjetjet që ka sjellë para tyre Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, i cili është organi kushtetues apo dhoma kushtetuese, në të cilat apelohej çdo vendimarrje e Këshillit të Lartë Gjyqësor

“Në momentin që përfundon procesi gjyqësor, atëherë i lind e drejta Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të evidentojë në bazë ankese, nëse ka pasur shkelje apo nuk ka pasur shkelje, një sjellje të një gjyqtari apo prokurori, por jo të prekë vendimmarrjen, e cila është marrë nga gjykata dhe prokuroria”.

apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Shumë çështje kanë shkuar në këtë institucion, pra në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe në të gjitha rastet, që ka pasur përpara Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në çdo rast është konfirmuar procedura e drejtë e ndjekur, si nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por edhe nga Këshillat përkatës. Edhe kjo pa dyshim i ka bërë gjyqtarët dhe prokurorët më të kujdesshëm në zbatimin e këtij instituti të së drejtës tashmë.”

I pyetur në lidhje me proceset gjyqësore të dy palëve në Partinë Demokratike tashmë në Apel dhe nëse ILD mund të ketë një mënyrë që ky proces të avancojë më shpejt, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u përgjigj:

“Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, kjo është çështje njëlloj si të tjerat. Nuk ka asnjë emocion të veçantë sepse sa emocion mund të paraqesë për një pjesë të publikut kjo çështje krahasimisht me çështje të tjera. Në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka ankese me problematika edhe më të thella ndoshta, që nuk janë kaq publike. Ka njerëz që ankohen për vrasje të pazbuluara, për punë të dobët të prokurorisë dhe gjykatave dhe unë nuk dua të peshoj rastet këtu, por kjo është për të treguar, pse nuk ka asnjë emocion puna e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në trajtimin e ankesave. Kjo është një çështje si gjithë të tjerat, ajo që është e rëndësishme të theksoj këtu dhe për këdo është që





Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ndërhyt në procese gjyqësore, nuk bën asnjë akt, asnjë veprim që të krijojë përshtypjen, që ndikon në vendimmarrjen e ardhshme të gjykatës apo prokurorisë. Në momentin që përfundon procesi gjyqësor, atëherë i lind e drejta Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të evidentojë në bazë ankese, nëse ka pasur shkelje apo nuk ka pasur shkelje, një sjellje të një gjyqtari apo prokurori, por jo të prekë vendimmarrjen, e cila është marrë nga gjykata dhe prokuroria. Kjo është të theksohet, që nuk ka asnjë akt apo një veprim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, jo për këtë çështje por për asnjë çështje, as për të përshpejtuar, as për të ngadalësuar proceset gjyqësore, as për të ndërhyrë, as për të mos ndërhyrë. Çdo ankesë në qoftë se ka, çdo çështje do të marrë atë rrugë që parashikon ligji, në përfundim të procesit gjyqësor.

Pra dua ta theksoj, Inspektori i lartë i drejtësisë nuk zëvendëson organet gjyqësore.” I pyetur se a mund të bëjë diçka ILD për shqetësimin e ngritur nga prokurorët e SPAK, se nuk po mbrohen si duhet nga KLP përballë deklaratave politike ndaj tyre, Metani tha se drejtësinë nuk mund ta vendosim, apo ta përmirësojmë me deklarata dhe se secili nga institucionet duhet të flasë me punë, e jo me deklarata.

“Deklarata politike për punën e sistemit gjyqësor ka çdo ditë dhe natyrisht institucionet nuk do të rrinë të bëjnë deklarata, nuk është kjo detyra e tyre. Ajo që është e rëndësishme është që pavarësinë, institucionet e reja të drejtësisë nuk e japin duke bërë deklarata, ose nuk e demonstrojnë duke bërë deklarata, por me aktet e tyre, dhe ajo që është e rëndësishme të theksoj, për sa e përket punës së ILD-së, është që mbi 80

magjistratë të hetuar sot, apo rreth 30 të proceduar disiplinarisht, as KLGJ, as KLP, as Kolegji i Posaçëm i Apelimit por qoftë edhe media, nuk kanë transmetuar asnjë mesazh të vetëm, që këta magjistratë janë hetuar politikisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, apo se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është vënë në lëvizje për të hetuar këta magjistratë për arsye politike, apo për shkak të ndërhyrjeve politike. Çdo ndërhyrje ka qenë e justifikuar ligjërisht dhe kjo është e konfirmuar, si nga Këshillat, ashtu dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe kjo është e rëndësishme të theksohet si standard pune.

Këtë e theksoj jo për punën që kanë bërë inspektorët e ILD-së, apo qoftë edhe Këshillat, por është për të theksuar, se reforma në drejtësi fillon nga këto garanci, që ne duhet t'i japim gjyqtarëve dhe prokurorëve, që gjyqtari dhe prokurori të jetë i pandjeshëm nga presionet, që mund t'i bëhen në media apo nga politika. Institucioni i vetëm që mund të ndërhyjë politikisht, të përdorë mjetin ligjor, për të ndërhyrë politikisht në vendimarrjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve është ILD fillimisht, dhe në asnjë rast, dëshiroj ta

theksoj dhe njëherë, nuk ka pasur evidenca të kësaj ndërhyrje të ILD-së, dhe kjo është garancia më e madhe, që unë dhe kolegët e mi mund t'i japim sistemit. Dua ta evidentoj edhe më shumë, është e rëndësishme që gjyqtarët dhe prokurorët të ndihen të lire, sepse siç e thatë dhe ju, ka pasur deklarata, që ndoshta janë ndjerë të intimiduar gjyqtarët ose prokurorët, por deklarata të tilla mund të ketë. Çështja është a ndihemi ne, sa ndikohemi ne nga ky presion dhe unë nuk mendoj që gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë kanë arsye, që mund të intimidohen ligjërisht, po them nuk kanë asnjë rast të mendojnë, që zyra e ILD apo edhe e Këshillave të keqpërdoret politikisht, që është një garanci e madhe për punën e tyre."

Në vijim të insistimit të gazetarëve për raportin e mosbesimit reciprok mes sistemit të drejtësisë dhe medias, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vërejt se "çdo aspekt, çdo dimension i punës së çdo zyrtari publik duhet të jetë i kontrollueshëm nga publiku, dhe media është përçuesi më i fortë i zërit të publikut. Nga ana tjetër kemi edhe një parim të rëndësishëm, që është parimi i pavarësisë së

"Ajo që është e rëndësishme të theksoj, për sa e përket punës së ILD-së, është që mbi 80 magjistratë të hetuar sot, apo rreth 30 të proceduar disiplinarisht, as KLGJ, as KLP, as Kolegji i Posaçëm i Apelimit por qoftë edhe media, nuk kanë transmetuar asnjë mesazh të vetëm, që këta magjistratë janë hetuar politikisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, apo se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është vënë në lëvizje për të hetuar këta magjistratë për arsye politike, apo për shkak të ndërhyrjeve politike".

gjqqtarëve e prokurorëve. Të dyja këto janë parime të mishëruara në kushtetutë, që gjenden në kushtetutë dhe asnjëra prej tyre nuk ka epërsi ndaj tjetrës. Të dyja kanë funksione të veçanta, kanë detyra të veçanta, kanë mbrojtje të veçantë.”

këtë thotë shteti i së drejtës, e thotë kushtetuta, por ajo që është e rëndësishme është që vendimet gjyqësore duhen komentuar. Vendimi është një akt publik, është vendimi i një zyrtari publik dhe padyshim që komentohet.

“E kam dëgjuar shpesh edhe shprehjen që vendimet gjyqësore nuk komentohen, por zbatohen. Në fakt unë s’do isha plotësisht dakord me këtë. Do thoja që vendimet padyshim që duhen zbatuar, sepse ky është parimi bazik i shtetit të së drejtës, jo sepse ne denjojmë t’i zbatojmë vendimet e gjyqësorit, por sepse

Ka të bëjë padyshim edhe me ato që thamë që kufijtë, konturet e diskursit politik mbi një vendim gjyqësor, ka të bëjë me kulturën politike, ka të bëjë me kulturën ligjore dhe shëndetin demokratik të një shoqërie. Kjo duhet kultivuar. Por që vendimet gjyqësore padyshim, sot e kësaj dite diskuto-

“Vendimi është një akt publik, është vendimi i një zyrtari publik dhe padyshim që komentohet. Ka të bëjë padyshim edhe me ato që thamë që kufijtë, konturet e diskursit politik mbi një vendim gjyqësor, ka të bëjë me kulturën politike, ka të bëjë me kulturën ligjore dhe shëndetin demokratik të një shoqërie. Kjo duhet kultivuar”.

hen vendime të Gjykatës së Lartë amerikane apo vendime të Gjykatës Europiane të Strasburgut, apo edhe vendime të tjera por nuk ka rëndësi. Ajo që dua të theksoj këtu është kjo, se puna e gjyqtarëve e prokurorëve apo beteja e gjyqtarëve e prokurorëve dhe e institucioneve të reja të drejtësisë nuk është me median.

Beteja jonë është me transparencën. Beteja jonë është me të vërtetën. Sa më i qartë të jetë gjyqtari e prokurori, sa më i qartë, pa ekuivok, pa lakime të jenë vendimet gjyqësore, vendimet e institucioneve tona, aq më i qartë është padyshim edhe gazetari, që do e raportojë si kronikë e padyshim edhe

komenti i gazetarit mbi këtë kronikë. Dhe do jetë publiku ai që do vlerësojë edhe vendimin, edhe komentin e gazetarit, edhe komentin e politikanit, edhe komentin e kujtdo. Dhe prandaj beteja me transparencën është beteja me të vërtetën. Vlerësuesi është publiku, edhe i punës sonë, edhe i punës së gazetarit, edhe i punës së politikanit. Ka një specifikë këtu, për hir të së vërtetës, sepse padyshim në media edhe në politikë dëgjon edhe deklarata që nuk i shkojnë të vërtetës...”, tha z. Metani.



KLP PRANON KËRKESËN E ILD PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATIT E.K.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë pranoi kërkesën magjistratit, ka cenuar rëndë imazhin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “shkarkim nga detyra”, për magjistratin E.K. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe Drejtues i caktuar përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Prokurori E.K. është dënuar me vendim të formës së prerë me 2 vjet e 4 muaj burgim për kryerjen e veprës penale të “Korrupsion të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, ç’ka përbën “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”. E.K. ka diskretituar pozitën dhe figurën e

magjistratit, ka cenuar rëndë imazhin e drejtësisë dhe ka ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

Për pasojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë i kërkoi Këshillit të Lartë i Prokurorisë administrimin e provave të paraqitura nga ana e ILD në këtë procedim disiplinor dhe pranimin e kërkesës së ILD për caktimin ndaj magjistratit E.K. të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës dhe nga neni 104, pika 3 e ligjit nr. 96/ 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE



Gjatë asistimit të ankuesve

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet

ankesa e tyre. Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

*Gjatë muajit **Janar 2023**, Sektori i Ndhmës Juridike dhe Ankesave ka pritur **29 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe **27 telefonata me qytetarë**, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.*



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit dhe komunikon me kërkuenin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit **Janar 2023**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **18 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuetit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë.

- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin "Si pranohen ankesat".

JANARI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Janar 2023** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **62 ankesa**, të paraqitura nga qytetarët.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Janar 2023**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

- 38 vendime verifikimi, nga të cilat:
- 28 vendime verifikimi (Praktika të ILD-së);
- 15 vendime verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);

HETIME DISIPLINORE

- 1 vendim për mbyllje hetimi disiplinor për 2 magjistratë

ARKIVIME

186 vendime arkivimi nga 229 praktika të shqyrtuara:

- 68 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (ILD);
- 52 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD);

66 vendime arkivimi pas verifikimit, nga të cilat :


- 13 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD);
- 53 vendime arkivimi pas verifikimit (dosje të mbartura nga ish KLD).

SHPALLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit Janar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për 33 ankues, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuara prej tyre.

Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë 189 shpallje publike.



ANKETA- DUAM MENDIMIN TUAJ PËR ILD-NË

Komunikimi me publikun në funksion të transparencës mbetet një prioritet i vazhdueshëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Për të rritur komunikimin me qytetarët, Zyra e ILD ka hartuar dhe publikuar në faqen e internetit një Anketë, përmes së cilës kërkohet mendim mbi punën e deritanishme të institucionit. Anketa mund të plotësohet online ose fizikisht pranë ILD-së.



TRANSPARENCA DHE MONITORIMI I INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË I SHËRZEN MBROJTJES SË INTERESIT PUBLIK

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në aktivitetin përmblyllës të projektit “Me sytë nga drejtësia”, ku u prezantua dokumenti analitik i monitorimit të indikatorëve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, të matjes së performancës së institucioneve të pavarura, i hartuar nga Instituti për Studime Politike dhe Ligjore (IPLS) me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shqipëri/MATRA.

Në fjalën e tij z. Metani tha se edhe pse me interesa që ecin paralelisht, ku organet tona kanë në fokus sistemin e drejtësisë, e nga ana tjetër shoqëria civile monitoron rezultatet, kemi një qëllim të përbashkët, që është transparenca e të veprimtarisë, përmes publikimeve të rezultateve dhe mon-

itorim i tyre për të përmirësuar rolin tonë, të gjitha këto në mbrojtje të interesit publik dhe të rritjes së ndërgjegjësimit qytetar ndaj këtij procesi të rëndësishëm reformues.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerësoi monitorimin e bërë për Zyrën e ILD së duke nënvizuar se “Edhe pse me të drejtë, analizat marrin për bazë të dhëna statistikore dhe shifrat pa dyshim janë tregues të performancës në disa nivele, është thelbësore që të kuptojmë se drejtësia nuk mund të jetë statistikë, por standard. Pikërisht kjo është sfida e institucioneve të sistemit të drejtësisë, jo thjesht numra gjyqtarësh dhe prokurorësh të shkarkuar e proceduar, por vendosja e vlerave dhe standardeve të punës, që do të kultivohen dhe pasurohen për të ardhmen.”

Komenti i plotë i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Të nderuar,

Gjej rastin t'ju falënderoj për vëmendjen që i keni kushtuar performancës së institucioneve të reformës në drejtësi, e në veçanti Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në raportin e detajuar të monitorimit. Ky dokument, i konceptuar me analiza sasiore dhe cilësore të treguesve të përveçëm që tregojnë rezultate konkrete të përpjekjeve për të fuqizuar konsolidimin e institucioneve tona, në këtë fazë të ndërmjetme të zbatimit të SND II.

Padyshim, është momenti për të diskutuar mbi arritjet, sfidat por edhe mbi problematikat, që janë hasur në praktikë. Tryeza si këto, i shërbejnë më së shumti, marrjes së opinionëve dhe feedback-ut nga një audiencë, e cila monitoron kujdesshëm dhe me gjykim të ftohtë mbi veprimtarinë. Edhe pse me interesa, që ecin paralelisht, ku organet tona kanë në fokus sistemin e drejtësisë, e

nga ana tjetër shoqëria civile, që monitoron rezultatet, qëllimi mbetet i përbashkët, transparencë të veprimtarisë përmes publikimeve të rezultateve, monitorim i tyre për të përmirësuar rolin tonë, të gjitha këto në mbrojtje të interesit publik.

Indikatorët e matur për ILD-në tregojnë rezultate të dukshme, në drejtim të ngritjes së punës për të ndërgjegjësuar qytetarin, kjo jo vetëm për të treguar, se në ILD i kushtohet vëmendje e shtuar qytetarit, duke shqyrtuar imtësisht çdo pretendim, por edhe duke filluar hetime, të cilat janë denoncuar nga qytetarët përmes ankesave të bazuara ligjërisht. Në jo pak raste ILD ka filluar hetimin me ankesën e qytetarëve, ankesa të cilat kanë rezultuar me masa konkrete për magjistratët, disa të shkarkuar e disa me masa disiplinore në karrierën e tyre. Në të shkuarën e afërt, perceptimi për të ndëshkuar një magjistrat për shkelje disiplinore, konsiderohej barrierë e pathyeshme, e sot falë vëmendjes ndaj sistemit dhe përkushtimit kemi rezultate të preksh-





me. Rezultate të cilat janë arritur falë standardeve të punës, të krijuara mes sfidash të mëdha, por që kanë dhënë impakt në sistem, duke treguar se organet e sistemit të drejtësisë, janë ngritur dhe po ushtrojnë misionin kushtetues.

Çdo ankesë apo procedurë hetimore ndjek një rrugë të paracaktuar ligjërish, ndaj edhe përmes nxitjes së publikut për përcjelljen e ankesave në adresë të ILD-së, kemi ndërmarrë disa masa për të rritur ndërgjegjësimin dhe komunikimin me publikun, përmend këtu anketën drejtuar publikut, rubrikën e posaçme të pyetjeve të shpeshta, rubrika të faqes sonë, ku vihen në dukje, misioni dhe roli i ILD në sistemin e drejtësisë. Përmes ndërgjegjësimit, synojmë të nxisim edukimin dhe pritshmëritë për kryerjen e verifikimeve apo hetimeve ndaj sjelljeve apo performancës në tërësi të sistemit, duke garantuar pavarësisë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përmbushje të misionit dhe funksionit të tij, nuk vlerëson

se rritja e numrit të hetimeve apo rënia e tyre janë treguesi i vetëm i performancës apo i cilësisë. Shtrimi i rrugës për përcaktimin e standardeve të qarta, ruajtja e balancës mes interesit publik dhe pavarësisë së magistratëve për të ushtruar me përgjegjësi detyrat e tyre është sfida dhe prioriteti që duhet të udhëheqin punën. Cenimi i këtyre standardeve nga organet kompetente, qoftë në numër apo në procedurë do të kishin ndikim në performancën tonë.

Edhe pse me të drejtë, analizat marrin për bazë të dhëna statistikore dhe shifrat pa dy-





shim janë tregues të performancës në disa Sigurisht që në vetëm 3 vite veprimtari, nivele, është thelbësore që të kuptojmë se shumë është arritur, sikurse me të drejtë drejtësia nuk mund të jetë statistikë, por është evidentuar në raportin e monitorimit standard. Pikërisht kjo është sfida e institucioneve të sistemit të drejtësisë, jo thjesht dhe akoma më shumë mbetet për t’u realizuar, deri në gjetjen e ekuilibrave ndërmjet numra gjyqtarësh dhe prokurorësh të konkurrencës së interesave legjitimë, prandaj shkarkuar e proceduar, por vendosja e vlerave në vizionin tonë të punës kemi zgjedhur të dhe standardeve të punës, që do të kultivohen dhe pasurohen për të ardhmen.

Ju faleminderit!





INTERVISTA E PLOTË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË Z. ARTUR METANI DHËNË PËR GAZETARËT DENIS MINGA DHE LORENC VANGJELI NË EMISIONIN “KONTRAST” NË REPORT TV

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani Kënaqësi gjithashtu.

ka bashkëbiseduar me gazetarët Denis Minga dhe Lorenc Vangjeli mbi punën e institucionit që drejton si dhe sfidat që ka drejtësia në përgjithësi përballë pritshmërive të publikut e raporti me median e politikën. Mesazhet kryesore gjenden me video në fund të intervistës.

Gazetari Denis Minga: I ftuari i mbrëmjes së sotme është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani. Mirëmbërëma, mirë se erdhët z. Metani!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Fa-leminderit për ftesën.

Gazetari Denis Minga: Kënaqësi që ju kemi në studio me ne në emisionin “Kontrast”.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani:

Gazetari Denis Minga: Do të kemi mundësi të flasim gjerë e gjatë për sa i përket asaj çfarë është institucioni juaj, në kuadër të ngrehinës së institucioneve të drejtësisë. Zoti Metani përpara se të nis diskutimin do doja t’ju kujtoja një konferencë, ndoshta konferencën tuaj të pare. Kemi një sinkron dhe rikthehemi në studio për të bërë një analizë të punës së institucionit tuaj si ka ecur gjatë këtij tre vjeçari, ta shohim dhe kthehemi në studio.

Vendoset inserti

Gazetari Denis Minga: Rikthehemi, nga ajo që keni përmendur në konferencën e parë, a është kompletuar institucioni juaj, a jeni i kënaqur?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Në momentin e krijimit, në 1 shkurt të vitit 2020, institucioni pati shumë sfida, por unë nuk do doja të ndalesha më në sfidat e ngritjes së institucionit, sepse edhe qytetarët nuk kanë më dëshirë dhe nuk kanë luksin të dëgjojnë më sfidat me të cilat është hasur institucioni i Inspektorit të Lartë të drejtësisë. Sot jemi në të tjera kushte pune të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Natyrisht pjesa e burimeve njerëzore veçanërisht në pjesën e inspektorëve magistratë, është një shqetësim që mbetet në punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por kjo nuk ka ndikuar aspak në ngritjen e institucionit në dimensione dhe standarde demokratike dhe kushtetuese, sipas parashikimeve për të cilat u krijua nga reforma në drejtësi dhe vetë institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Institucioni tashmë ka standarde të vendosura; institucioni tashmë ka kriteret e qarta të punës së vet; institucioni tashmë ka zërin e vet në punën e magistratëve në Republikën e Shqipërisë; in-

stitucioni po funksionon dhe ky ishte qëllimi im dhe i kolegëve të mi, në momentin që u krijua institucioni, që institucioni të bëhej funksional dhe më pas të japë rezultate, sepse nuk mund të ndodhte e kundërta. Nuk mund të kishe rezultate dhe më pas të funksiononte institucioni.

Gazetari Denis Minga: Keni një bilanc pothuajse trevjeçar. Për publikun le ta bëjmë më të thjeshtë, Institucioni juaj është ngritur për të gjykuar kur prokurorët dhe gjyqtarët shkelin ligjin, pak a shumë, sepse jam i thjeshtë në mënyrën e të përmbledhurit të mënyrës së funksionimit të institucionit tuaj. Deri tani sa prokurorë dhe gjyqtarë kanë qenë në lupën tuaj?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Në tre vite të funksionimit të Institucionit janë hetuar ose janë vlerësuar dosjet e mbi 80 magistratëve, gati 30 prej tyre kanë shkuar për procedim disiplinor pranë Këshillit të Lartë



"Procesi gjyqësor është tjetër gjë dhe shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të tjera gjëra. Ajo që është e rëndësishme të theksohet për publikun dhe këdo tjetër është që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nuk zëvendëson organe të tjera gjyqësore dhe punën e tyre".

Gjyqësor dhe pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që është një numër i madh, për kushtet në të cilat ishte Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Por ajo që është e rëndësishme dhe që dua ta theksoj për publikun, natyrën e punës dhe funksionin që ka institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Puna e gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë demokratike kontrollohet nga gjykatat apo prokuroritë më të larta. Kjo është ajo që quhet kontroll i brendshëm i punës së gjykatave dhe prokurorive. Veç këtyre për të bërë këtë balancën e interesit publik, se si e menaxhojnë drejtësinë gjyqtarët dhe prokurorët, janë ngritur institucione siç është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në Shqipëri apo edhe në vende të tjera, një kontroll i jashtëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kontroll i jashtëm nuk do të thotë kontroll i pavarësisë së punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve, do të thotë kontroll i atyre shkeljeve të natyrës disiplinore, që mund të kryejnë gjyqtarët dhe prokurorët. E rëndësishme është që këto shkelje apo këto gabime në punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk janë shkelje për të cilat duhen marrë masa gjatë kohës së procesit gjyqësor. Procesi gjyqësor është tjetër gjë dhe shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve janë të tjera gjëra. Ajo që është e rëndësishme të theksohet për publikun dhe këdo tjetër është që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nuk zëvendëson organe të tjera gjyqësore dhe punën e tyre. Kjo është shumë e rëndësishme, çdo ndërhyrje e këtij kontrolli të

jashtëm, pra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë një procesi gjyqësor është ndërhyrje në punën e brendshme, apo bindjen e brendshme, apo në pavarësinë e gjykatave dhe prokurorëve, gjë që është jo e shëndetshme demokratikisht dhe padyshim e dënueshme.

Gazetari Denis Minga: Ne gjatë bisedës do trajtojmë disa fenomene që kemi konstatuar si gazetarë, në raport me disa vendime të çuditshme të prokurorëve dhe gjyqtarëve. Lorenc si e shikon rolin e ILD-së në të gjithë ngrehinën e reformës në Drejtësi?

Gazetari Lorenc Vangjeli: Nëse vettingu është një proces i përkohshëm, është filtri i parë nëpër të cilin kalon e gjithë trupa e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ILD-ja është filtri institucional që do të mbetet, pra nuk përfundon historia, është një prag tjetër që duhet kapërcyer, është nga ato pragjet që vendoset vendim pas vendimi. Unë, duke ju referuar konferencës së parë, ky është një tre vjeçar, duket sikur bëhet edhe një bilanc i punës, kujtoj mirë që në atë kohë ka pasur një shqetësim të madh publik që kishte të bënte me një serial lirimesh të personazheve shumë të njohur të botës së krimit shumica e tyre të dënuar me burgim të përjetshëm të cilët kërkonin rishikimin e vendimit ose lirimin para kohe me kusht. Ishte bërë një fenomen i cili kishte trazuar komplet politikën dhe ju e keni evidentuar ndër të parët atje. Unë do të doja të



dija, pavarësisht se raportimet e vazhdueshme japin një pamje tjetër. Në këndvështrimin tuaj ky shqetësim i juaj fillestar ku qëndron sot?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Mendoj që është e rëndësishme të theksohet, se në momentin kur u ngrit Zyra e Inspektorit të lartë të drejtësisë kishte shumë presion, presion të gjithanshëm, presion politik, në kuptimin e pritshmërive për punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, presione nga publiku për pritshmëritë që kishte, presione nga trupa e magistratëve për atë që do të ndodhte në punën e tyre në të ardhmen dhe nga ana tjetër, po ashtu legjitime, ishte kontrolli mbi punën e gjykatave dhe prokurorëve, siç ishte rasti i zbatimit të institutit të lirit para kohe me kusht nga gjykatat dhe prokuroritë. Në atë kohë, me të drejtë e evidentoi zoti Vangjeli, ishte fenomen shqetësues nëpër gjykata dhe prokurori, apo dhe në mjedisin politik, publik dhe mediatik të kohës. Unë mendoj që kjo do ishte ndërhyrja e parë e

rëndësishme e Inspektorit të lartë të Drejtësisë. Sot jam shumë optimist për punën e kryer, krenar për punën e inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sepse puna e tyre, jo vetëm që përballoi këtë presion, për të cilin thashë, por gjeti balancën e duhur midis këtij presioni, por edhe kontrollit të punës së prokurorisë dhe gjykatave. Ky kontroll, kjo procedurë e ndjekur nga Inspektori i lartë i drejtësisë është konfirmuar tashmë edhe nga Këshillat, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për gjetjet që ka sjellë para tyre Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, i cili është organi kushtetues apo dhoma kushtetuese, në të cilat apelohet çdo vendimmarrje e Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Shumë çështje kanë shkuar në këtë institucion, pra në Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe në të gjitha rastet, që ka pasur përpara Kolegji i Posaçëm i Apelit, në çdo rast është konfirmuar procedura e drejtë e ndjekur, si nga Inspektori i

Lartë i Drejtësisë, por edhe nga Këshillat përkatës. Edhe kjo pa dyshim i ka bërë gjyqtarët dhe prokurorët më të kujdesshëm në zbatimin e këtij instituti të së drejtës tashmë.

Gazetari Lorenc Vangjeli: *T'ju pyes për diçka. Ka një seri keqkuptimesh sa herë bëhet fjalë për Institucionin tuaj, apo për drejtësinë në përgjegjësi. Në publik është krijuar ideja se ju jeni një gjykatës mbi gjykatësit, çdokush mendon që gjatë një procesi gjyqësor, kur është vënë re, që mund t'i shkelen të drejtat, kur mendon që po shkohet drejt një vendimi të gabuar, mendon që mund të trokitet tek ju. Por e thënë më thjeshtë në çfarë mënyre mund të vijë dhe të trokasë tek ju ankesa e publikut?*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Sot unë jam shumë i kënaqur që publiku ka mundësi dhe ka gjetur çdo rrugë ligjore, që është bërë publike nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Pra Inspektorit të Lartë të drejtësisë i dërgohen ankesa nëpërmjet faqes së internetit të Zyrës së inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mund të ketë ankesa me postë, ankesa të drejtpërdrejta. Nëse vihet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një ekip me dy ose tre specialistë, që e ndihmojnë ankuesin të plotësojë ankesën dhe të trajtojë ankesën ashtu siç e parashikon ligji. Edhe jam i kënaqur sepse numri i ankesave tregon jo vetëm shqetësimet që ata kanë në fakt për sistemin gjyqësor, por besoj që është edhe një

besim për punën e institucionit. Sot nuk vërej asnjë shqetësim të kontaktit të publikut me Zyrën e inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pra unë mendoj se është e qartë procedura që ndjek, apo aksesit që kanë qytetarët tek Zyra dhe tek puna e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Gazetari Denis Minga: *Me ndihmën e regjisë do doja ta kishim një grafikë, që institucioni juaj na ka sjellë, në raport me atë, që si duhet të drejtohen qytetarët, pasi në fund të fundit shërbimi i institucionit tuaj është për qytetarët. Ju thatë Zoti Metani që ka një rritje të ankesave. Ankesa të cilat gjejnë përgjigje apo le të themi mbeten në kuadër të ankesës dhe vështirësisht gjejnë përgjigje. Si ka qenë bilanci i këtyre tre viteve?*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Në momentin që u krijua institucioni, siç u përmend në konferencën për shtyp, që ju sollët në fillim, institucioni gjeti një numër të lartë ankesash të patrajtuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Ministri i Drejtësisë, për shkak se pritej ngritja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky numër i lartë ankesash të patrajtuara, të prapambetura le të themi, që quhet në zhargon “backlog”, ishte numri i madh, që do i shtohet edhe valës së re të ankesave, që do i vinte Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për këtë arsye Inspektori i Lartë i

“Nëse vihet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një ekip me dy ose tre specialistë, që e ndihmojnë ankuesin të plotësojë ankesën dhe të trajtojë ankesën ashtu siç e parashikon ligji”.

"Sot numri i ankesave që janë përpara Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është rreth 5100 ankesa. Nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë trajtuar rreth 3500 ankesa, që janë pjesë e ankesave të prapambetura dhe pjesë e atyre të fillimit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".

Drejtësisë ka zhvilluar një metodologji, se si do trajtonte të gjithë këtë grup të madh ankesash, ankesa të vjetra, por edhe të reja. Kjo metodologji zbatohet sot! Sot numri i ankesave që janë përpara Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është rreth 5100 ankesa. Nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë trajtuar rreth 3500 ankesa, që janë pjesë e ankesave të prapambetura dhe pjesë e atyre të fillimit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Çdo ankesë do marrë përgjigje në kohën e duhur dhe nuk do ngelet asnjë pa u trajtuar. E them me bindje këtë sepse kemi pasur ankesa, të cilat janë trajtuar dhe për shkak të këtyre ankesave. Janë proceduar edhe magjistratë, të cilët menduan se nuk do trajtoheshin, për shkak të prapambetjes së këtyre ankesave. Pikërisht për të dhënë mesazhin, që çdo ankesë trajtohet dhe çdo shkelje e provuar do të vijë përpara ligjit dhe përpara Këshillave, siç e parashikon ligji. Do plotësohet ai synim për të cilin u krijua reforma në drejtësi, të luftohet kultura e pandëshkueshmërisë.

Gazetari Denis Minga: Lorenc do ta bëj edhe si në formë batute këtë, sepse përgjigjen më serioze do ta marr nga zoti Metani. Tani po më shkon ndërmend, që një nga dy grupet ose dy grupet e PD-së, duhet ta çojë një ankesë në ILD, se pse nuk po trajtohet çështja e statusit të Partisë Demokratike, ndoshta zoti Metani mund ta merrte përsipër t'i jepte përgjigje për shembull, pse po vonohet procesi i fatit të

Partisë demokratike?

Gazetari Lorenc Vangjeli: Media vepron ndryshe, qoftë edhe nga institucioni i zotit Metani. Ne veprojmë me opinione, ata veprojnë me prova. Një pyetje të tillë unë do ta shtroja në mënyrë më serioze. Sa shanse ka, sa gjasa ka kur një proces i tillë, që ka një rëndësi të jashtëzakonshme, bëhet fjalë për një nga institucionet më të rëndësishme të vendit, që është opozita, vazhdon të qëndrojë në Apel. Ndoshta formalisht janë duke u respektuar afatet, por në çfarë mënyre trokitet tek ju, apo cila është dera tjetër, ku mund të trokitet, për të thënë që nëse historia apo basti i dy vëllezërve, për të thënë që për një gardh që kalon në mes, pavarësisht se ka kohë më të shpejtë për t'u gjykuar, pra është më herët në radhë. Çfarë duhet bërë që një çështje e tillë, të kalojë radhën, ose a ka ndonjë mekanizëm tjetër, që vendos hierarkinë e shqyrtimit të çështjeve?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, kjo është çështje njëlloj si të tjerat. Nuk ka asnjë emocion të veçantë sepse sa emocion mund të paraqesë për një pjesë të publikut kjo çështje krahasimisht me çështje të tjera. Në zyrën e Inspektorit të lartë të Drejtësisë ka ankesa me problematika edhe më të thella ndoshta, që nuk janë kaq publike. Ka njerëz që ankohen për vrasje të pazbuluara, për punë të dobët të

prokurorisë dhe gjykatave dhe unë nuk dua të peshoj rastet këtu, por kjo është për të treguar, pse nuk ka asnjë emocion puna e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në trajtimin e ankesave. Kjo është një çështje si gjithë të tjerat, ajo që është e rëndësishme të theksoj këtu dhe për këdo është që Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ndërhyr në procese gjyqësore, nuk bën asnjë akt, asnjë veprim që të krijojë përshtypjen, që ndikon në vendimmarrjen e ardhshme të gjykatës apo prokurorisë. Në momentin që përfundon procesi gjyqësor, atëherë i lind e drejta Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të evidentojë në bazë ankesë, nëse ka pasur shkelje apo nuk ka pasur shkelje, një sjellje të një gjyqtari apo prokurori, por jo të prekë vendimmarrjen, e cila është marrë nga gjykata dhe prokuroria. Kjo është të theksohet, që nuk ka asnjë akt apo një veprim të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, jo për këtë çështje por për asnjë çështje, as për të përshpejtuar, as për të ngadalësuar proceset gjyqësore, as për të ndërhyrë, as për të mos ndërhyrë. Çdo ankesë në qoftë se ka, çdo çështje do të marrë atë rrugë që parashikon ligji, në përfundim të procesit gjyqësor. Pra dua ta theksoj, Inspektori i lartë i drejtësisë nuk zëvendëson organet gjyqësore.

Gazetari Lorenc Vangjeli: *Pra ju e hidhni poshtë, ndoshta sqaroni më së miri, atë keqkuptimin që nuk mund të jeni gjykatësi i gjykatësve?*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Padyshim! E cekta në fillim, ajo ndarja që bëra, kontrolli i brendshëm dhe kontrolli i jashtëm. Është shumë e rëndësishme të theksohet kjo gjë. Pse? Jo sepse po mbulojmë punën e dobët të gjykatave dhe prokurorive, jo sepse me këtë duam të mbulojmë apo justifikojmë edhe sjellje tonat, jo sepse gjykatat dhe prokuroritë e kanë çështjen e pavarësisë,

si mburojë që i mbron nga gjithçka. Por nëse një gjyqtar apo prokuror do dënohet disiplinisht për një vendim të vetin, për një bindje të vetën, nëse nuk përdoren institucionet që ka ngritur Kushtetuta për të trajtuar ankesat ndaj vendimeve gjyqësore apo ndaj shkeljeve të gjyqtarëve, apo më keq akoma nëse pushtete të tjera, duan të keqpërdorin mungesën e mundësisë ligjore, që magjistratët kanë për t'u shprehur në publik për vendimet e tyre, atëherë unë mendoj se nuk kemi zgjidhur asgjë me reformën në drejtësi, por vetëm i zgjasim agoninë përpjekjeve tona për zhvillim.

Gazetari Lorenc Vangjeli: *Zoti Metani nga politika ka vazhdimisht akuza, pakënaqësi përplasje dhe presion, ndërkohë që gjyqësori vendos të heshtë, në këtë lloj dualizmi ku qëndron institucioni juaj dhe si e mendoni, a ka vërtetë ndërhyrje politike në sistem?*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Kjo është një pyetje që ngrihet shpesh, unë e kam theksuar dhe në intervista të tjera dhe këtu do doja të bëja një parantezë, që unë nuk dal rrallë në media, madje dal më shpesh sesa duhet, por këtë e bëj për një qëllim, që njerëzit, media dhe politika të kuptojë mënyrën sesi e mendon zyra e ILD funksionin e tij, sesi mundohet të ushtrojë kompetencat e veta. Padyshim unë nuk mund të bëj publike ankesat sepse janë individuale, unë nuk mund të bëj publike hetimet, që bën Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por duke shpjeguar filozofinë e punës së ILD-së, mendoj se gjithkush e krijon mendimin, sesi duhet të funksionojë dhe si funksionon një institucion. Për të ardhur tek përgjigja juaj, është pak delikate, është delikate, jo për shkak të politizimit të gjësë, por unë mendoj që është delikate për raportet, që duhet të krijojë në shoqëri, drejtësia me politikën, balancën e ndarjes së

"Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr një vendim, ky vendim është i ankimueshëm pranë Këshillave, pra në kuptimin e ndarjes së pushteteve, çdo institucion është i kontrollueshëm nga institucioni tjetër, për të shmangur çdo mundësi abuzimi me detyrën".

pushteteve. Reforma në drejtësi vërtetë krijoi një arkitekturë të re institucionesh, pra krijoi një ILD, KLGJ, KLP me kompetencat e veta, gjithashtu dhe për mua ka bërë një ndarje shumë të mirë të punës dhe kontrollit të këtyre institucioneve, pra gjithkush nga institucionet e reja, sot është i kontrollueshëm nga ligji dhe nga institucione të tjera. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr një vendim, ky vendim është i ankimueshëm pranë Këshillave, pra në kuptimin e ndarjes së pushteteve, çdo institucion është i kontrollueshëm nga institucioni tjetër, për të shmangur çdo mundësi abuzimi me detyrën. Nga ana tjetër, kjo mënyrë e krijimit të institucioneve, padyshim që u krijua mbi bazën e një filozofie, siç është ndarja e pushteteve, por këtë filozofi ndërtimi, këtë filozofi e ndarjes së punës në shtet, nuk e shoh akoma të transmetuar në mjedisin politik, publik, që njerëzit të flasin për të sesa e rëndësishme është kjo ndarje e pushteteve për një shoqëri demokratike. E theksoj edhe njëherë, nuk flas për të mbrojtur shkelje eventuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, apo të punës sonë në momente të caktuara, por kjo është një gjë parimore, për të folur sesa e shëndetshme është për shoqërinë respektimi i këtij parimi.

Gazetari Denis Minga: *Një shqetësim i ngritur nga prokurorët e SPAK-ut, që u vunë në sulm*

madje, u tha që KLP nuk po i mbron si duhet, edhe pse ishte qeverisja e tyre, ndërkohë a mund të bëjë diçka më tepër ILD në këtë rast?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Në fakt është bërë disa herë thirrje, edhe nga politikanë të ndryshëm, që institucionet e reja, veçanërisht ato të drejtësisë, duhet të tregojnë pavarësinë e tyre, duke deklaruar pavarësinë e tyre në situata të tilla. Për hir të së vërtetës, unë kam reaguar vetëm një herë në një rast vitin e kaluar, KLP ka reaguar më shumë se një herë besoj, KLGJ ka reaguar më shumë se një herë, por unë nuk mendoj, që nuk është kjo rruga për dy arsye. E para, deklarata politike për punën e sistemit gjyqësor ka çdo ditë dhe natyrisht institucionet nuk do të rrinë të bëjnë deklarata, nuk është kjo detyra e tyre. Ajo që është e rëndësishme është që pavarësinë, institucionet e reja të drejtësisë nuk e japin duke bërë deklarata, ose nuk e demonstrojnë duke bërë deklarata, por me aktet e tyre, dhe ajo që është e rëndësishme të theksoj, për sa e përket punës së ILD-së, është që mbi 80 magjistratë të hetuar sot, apo rreth 30 të proceduar disiplinarisht, as KLGJ, as KPL, as Kolegji i Posaçëm i Apelit, por qoftë edhe media, nuk kanë transmetuar asnjë mesazh të vetëm, që këta magjistratë janë hetuar politikisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, apo se Inspektori

"Institucioni i vetëm që mund të ndërhyjë politikisht, të përdorë mjetin ligjor, për të ndërhyrë politikisht në vendimmarrjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve është ILD fillimisht, dhe në asnjë rast, dëshiroj ta theksoj dhe njëherë, nuk ka pasur evidenca të kësaj ndërhyrje të ILD-së, dhe kjo është garancia më e madhe, që unë dhe kolegët e mi mund t'i japim sistemit. Dua ta evidentoj edhe më shumë, është e rëndësishme që gjyqtarët dhe prokurorët të ndihen të lire, sepse siç e thatë dhe ju, ka pasur deklarata, që ndoshta janë ndjerë të intimiduar gjyqtarët ose prokurorët, por deklarata të tilla mund të ketë. "

i Lartë i Drejtësisë është vënë në lëvizje për të hetuar këta magistratë për arsye politike, apo për shkak të ndërhyrjeve politike. Çdo ndërhyrje ka qenë e justifikuar ligjërisht dhe kjo është e konfirmuar, si nga Këshillat, ashtu dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe kjo është e rëndësishme të theksohet si standard pune. Këtë e theksoj jo për punën që kanë bërë inspektorët e ILD-së, apo qoftë edhe Këshillat, por është për të theksuar, se reforma në drejtësi fillon nga këto garanci, që ne duhet t'i japim gjyqtarëve dhe prokurorëve, që gjyqtari dhe prokurori të jetë i pandjeshëm nga presionet, që mund t'i bëhen në media apo nga politika. Institucioni i vetëm që mund të ndërhyjë politikisht, të përdorë mjetin ligjor, për të ndërhyrë politikisht në vendimmarrjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve është ILD fillimisht, dhe në asnjë rast, dëshiroj ta theksoj dhe njëherë, nuk ka pasur evidenca të kësaj ndërhyrje të ILD-së, dhe kjo është garancia më e madhe, që unë dhe kolegët e mi mund t'i japim sistemit. Dua ta evidentoj edhe më shumë, është e rëndësishme që gjyqtarët dhe prokurorët të ndihen të lire, sepse siç e thatë dhe ju, ka pasur deklarata, që ndoshta janë ndjerë të intimiduar gjyqtarët ose proku-

rorët, por deklarata të tilla mund të ketë. Çështja është a ndihemi ne, sa ndikohemi ne nga ky presion dhe unë nuk mendoj që gjyqtarët dhe prokurorët në Republikën e Shqipërisë kanë arsye, që mund të intimidohen ligjërisht, po them nuk kanë asnjë rast të mendojnë, që zyra e ILD apo edhe e Këshillave të keqpërdoret politikisht, që është një garanci e madhe për punën e tyre.

Gazetari Denis Minga: *Jemi në pjesën e dytë të emisionit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Lorenc doja ta merrnim pak aty ku z. Metani tha se tashmë prokurorët dhe gjyqtarët janë të lirë, pavarësisht deklaratave, nuk ka asnjë klimë që ata të intimidohen. Por realisht ndodh kështu sipas jush?*

Gazetari Lorenc Vangjeli: *Duhet të pohoja edhe një element më shumë tek ajo çka tha z. Metani, sepse përveç institucioneve të tjera, të cilat e kanë mohuar faktin e ndikimit politik në hetimet disiplinore që janë bërë ndaj gjyqtarëve deri tani, edhe vetë protagonistët, edhe vetë pjesëtarët e kësaj trupe prej rreth 30 magistratësh, të cilët janë proceduar, asnjë prej tyre nuk ka pasur një pretendim të tillë, që*

procesi ndaj tyre ka qenë i motivuar për arsye të ndryshme ekstra profesionale. Duke thënë këtë do doja të ndaja me ju z. Metani dy momente të rëndësishme. E para njëherë, bëri bujë në fund të vitit të shkuar një seri ankesash, të cilat edhe kur nuk vinin nga vetë protagonistët, nga prokurorët e SPAK-ut silleshin nga jashtë, kryesisht nga ambasadorja e SHBA-ve, për mundësi intimidimi, për presione, për shantazhe të formave të ndryshme e kështu me radhë. Unë do t'ju them diçka, e cila mund të tingëllojë si blasfemi: e kundërta do të ishte problem! Pra nëse mbi këtë trupë nuk do të kishte presion, nuk do të kishte shantazh, nuk do të kishte tentativë për të ndikuar në vendim-marrjen e tyre. Ata janë atje, pjesë e një sakrificë të epërme të shoqërisë shqiptare, e cila i paguan shumë, u ka krijuar kushte të posaçme pune, pikërisht për këtë arsye, që të përballojnë këto presione ngado që të vijnë. Dhe më ngjan e pabesueshme që të zgjidhet rruga e ankesës ndaj një prokurori të SPAK-ut, kur secili prej tyre, nëse do të ishte në rastin e një shantazhi, të mundshëm nga cilido krah që t'i vinte, ai vetë mund të niste një hetim ndaj burimit të këtij shantazhi. Pra në këtë rast nuk mund të ankohet rojtari ynë, që po i trokasim në derë. Besoj se është një gjë që do të duhej të tejkalohet. Ata nuk janë balerina. Ata janë atje me veshjet dhe parzmoret e një luftëtari në emër të interesit publik. Dhe kjo duhet kuptuar. Një balerinë mund të ankohet, por jo ata.

Kjo ishte e para. Dhe e dyta: edhe sot njëherë si përherë, Sali Berisha përmend një rast konkret. Unë do të refuzoja të hyja në histori të veçanta e me emra konkretë z. Metani por meqenëse është e freskët. Bëhet fjalë për një humbje jete në qelitë e paraburgimit, të një prej personazheve të arrestuar, i përfshirë në aferën e inceneratorëve. Përmendet edhe institucioni juaj dhe elementë të tjerë të arkitekturës së sistemit nuk kanë vepruar. A keni koment për këtë gjë

dhe a është trokitur në derën tuaj?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka asnjë ankesë për këtë çështje. E para. E dyta, nga ajo që lexoj në media, nuk shoh shkelje të magjistratëve, prokurorëve a gjyqtarëve që të përbëjnë shkelje disiplinore eventuale.

Gazetari Denis Minga: Meqë e prekëm këtu. Këto sulme që vijnë ndaj jush herë pas here ndaj figurës suaj nga Berisha, ju shqetësojnë, ju venë në siklet z. Metani, apo keni vendosur që çdo intimidim, çdo deklaratë politike të kalojë me një lloj mosvëmendje nga ana juaj?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Deklarata politike bëjnë të gjithë. Nuk do evidentojmë emra të veçantë, por e thashë, presioni nuk është politik vetëm, por është edhe mediatik edhe shoqëror, edhe me të drejtë, sepse tek e fundit fare, politika përfaqëson atë pjesë të interesit publik, që e legjitimon të interesohet për administrimin e drejtësisë nga gjyqtarët e prokurorët. Deri ku shtrihet gjuha e përdorur për këtë interes, për të shfaqur dhe për të transmetuar këtë interes publik, kjo është çështje që ka të bëjë me shumë elementë, e para. E dyta, nuk është çështje zgjedhjeje anashkalimi ose jo i deklaratave politike. Është çështje ligji. Pra, nëse deklarata do kishte elementë që do ishin flagrante, që do përbënin shkelje flagrante, që do e bënin të interesuar punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, padyshim do ishin çështje, që Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe besoj edhe institucione të tjera do i merrnin parasysh. Por e rëndësishme është se drejtësinë nuk mund ta vendosim me deklarata, apo ta përmirësojmë me deklarata. Kushtetuta, reforma në drejtësi, ligji kanë krijuar mekanizma se si funksionon kontrolli i punës së gjyqtarëve e prokurorëve dhe për këtë i bëj thirrje kujtdo, edhe politikës, edhe medias,

“Unë do të doja që çdo hap i punës sime dhe i zyrës sime të jetë i kontrollueshëm nga kushdo, ashtu siç e parashikon ligji. Për këtë arsye i bëj thirrje çdokujt, që nëse ka ankesa ndaj gjyqtarëve e prokurorëve, më mirë sesa deklaratat publike, le t’i drejtohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me shkrim, të marrin përgjigje, ashtu sikurse e parashikon ligji dhe nëse nuk janë të kënaqur, le ta ankimojnë atë vendim, pra le të ndjekin rrugën, që parashikon kushtetuta dhe ligji”.

edhe çdo qytetari tjetër, që të sjellë ankesë me shkrim pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pse e evidentoj këtë? E evidentoj këtë së pari për një arsye shumë themelore: nëse një qytetar, institucion, njeri politik, njeri mediatik sjell një ankesë tek Zyra e ILD-së, do të marrë një përgjigje. Nëse qytetari apo subjekti që ka paraqitur ankesën nuk është i kënaqur me përgjigjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, atëherë i lind e drejta ta ankimojë këtë vendim dhe të shkojë ose në Këshillin e Lartë Gjyqësor ose në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, sipas rastit. Por nëse një qytetar, një njeri politik apo mediatik bën thjesht deklarata publike dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë për një arsye apo për një tjetër, e nis një verifikim dhe e mbyll këtë verifikim, askush nuk ka të drejtë të kontrollojë këtë vendimmarrje të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe unë nuk do doja të isha në raste apo në situata të pa-kontrollueshme të punës sime. Unë do të doja që çdo hap i punës sime dhe i zyrës sime të jetë i kontrollueshëm nga kushdo, ashtu siç e parashikon ligji. Për këtë arsye i bëj thirrje çdokujt, që nëse ka ankesa ndaj gjyqtarëve e prokurorëve, më mirë sesa deklaratat publike, le t’i drejtohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me shkrim, të marrin përgjigje, ashtu sikurse e parashikon ligji dhe nëse nuk janë të kënaqur, le ta ankimojnë atë vendim, pra le

të ndjekin rrugën, që parashikon kushtetuta dhe ligji. Vetëm kështu mund ta sjellim frymën e respektimit të ligjit dhe të sjellim në konture kushtetutshmërie edhe sjelljen e inspektorëve, edhe sjelljen e gjyqtarëve, edhe sjelljen e prokurorëve, por edhe sjelljen e gjithkujt tjetër që ka ankesa ndaj punës së këtyre subjekteve.

Gazetari Lorenc Vangjeli: *A ka një raport të frakturuar shpesh të nisur edhe mbi baza mosbesimi, dyshimi reciprok ndoshta ndërmjet sistemit të drejtësisë dhe pushtetit të katërt, që është media. Si e shikoni këtë raport?*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Tani është e kotë të përmendet aksioma, që liria e medias është themelore, jetësore, vitale për shëndetin e një shoqërie demokratike. Është jetësore sepse çdo aspekt, çdo dimension i punës së çdo zyrtari publik duhet të jetë i kontrollueshëm nga publiku dhe media është përçuesi më i fortë i zërit të publikut. Nga ana tjetër kemi edhe një parim të rëndësishëm, që është parimi i pavarësisë së gjyqtarëve e prokurorëve. Të dyja këto janë parime të mishëruara në kushtetutë, që gjenden në kushtetutë dhe asnjëra prej tyre nuk ka epërsi ndaj tjetrës. Të dyja kanë funksione të veçanta, kanë detyra të veçanta, kanë mbro-

jtje të veçantë. E kam dëgjuar shpesh edhe shprehjen që vendimet gjyqësore nuk komentohen, por zbatohen. Në fakt unë s'do isha plotësisht dakord me këtë. Do thoja që vendimet padyshim që duhen zbatuar, sepse ky është parimi bazik i shtetit të së drejtës, jo sepse ne denjojmë t'i zbatojmë vendimet e gjyqësorit, por sepse këtë thotë shteti i së drejtës, e thotë kushtetuta, por ajo që është e rëndësishme është që vendimet gjyqësore duhen komentuar.

Gazetari Denis Minga: *Mirë që dolët këtu. Pra kemi mundësi t'i komentojmë...*

Gazetari Lorenc Vangjeli: *Kjo ka qenë një lloj tabuje që prapë hyn tek ajo seria e keqkuptimeve, që thuhet si aksiomë se aktet zbatohen, nuk komentohen.*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Vendimi është një akt publik, është vendimi i një zyrtari publik dhe padyshim që komentohet. Ka të bëjë padyshim edhe me ato që thamë që kufijtë, konturet e diskursit politik mbi një vendim gjyqësor, ka të bëjë me kulturën politike, ka të bëjë me kulturën ligjore dhe shëndetin demokratik të një shoqërie. Kjo duhet kultivuar. Por që vendimet gjyqësore padyshim, sot e kësaj dite diskutohen vendime të Gjykatës së Lartë amerikane apo vendime të Gjykatës Europiane të Strasburgut, apo edhe vendime të tjera por nuk ka rëndësi. Ajo që dua të theksoj këtu është kjo, se puna e gjyqtarëve e prokurorëve apo beteja e gjyqtarëve e prokurorëve dhe e institucioneve të reja të drejtësisë nuk është me median. Beteja jonë është me transparencën. Beteja jonë është me të vërtetën. Sa më i qartë të jetë gjyqtari e prokurori, sa më i qartë, pa ekuivok, pa lakime të jenë vendimet gjyqësore, vendimet e institucioneve tona, aq më i qartë

është padyshim edhe gazetari, që do e raportojë si kronikë e padyshim edhe komenti i gazetarit mbi këtë kronikë. Dhe do jetë publiku ai që do vlerësojë edhe vendimin, edhe komentin e gazetarit, edhe komentin e politikanit, edhe komentin e kujtdo. Dhe prandaj beteja me transparencën është beteja me të vërtetën. Vlerësuesi është publiku, edhe i punës sonë, edhe i punës së gazetarit, edhe i punës së politikanit. Ka një specifikë këtu, për hir të së vërtetës, sepse padyshim në media edhe në politikë dëgjon edhe deklarata që nuk i shkojnë të vërtetës...

Gazetari Lorenc Vangjeli: *Ka shumë rrugë për të arritur tek e vërteta, e cila prapë nuk është një...*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Dakord, por ajo që dua të them është se ne bëjmë përpjekje për të shkuar tek e vërteta dhe përpjekja për të shkuar tek e vërteta është duke bërë vendime të qarta, vendime të thjeshta, vendime pa lakime, pa ekuivoke. Kjo është detyra jonë, e gjyqtarëve dhe e institucioneve të drejtësisë. Detyra e të tjerëve është detyra e të tjerëve, por ajo që doja të theksoja këtu është që, se e përmendët edhe ju pak më parë, që gjyqtarë e prokurorët apo institucionet e reja të drejtësisë e kanë të ndaluar të komentojnë vendimet e tyre politikisht apo publikisht. Ata flasin me vendime dhe pamundësia e tyre për të folur shpeshherë edhe keqkuptohet, por edhe keqpërdoret nga faktorë të ndryshëm. Dhe kjo është një gjë që nuk i shërben askujt, sepse në fund të ditës, nëse intimidohen gjyqtarë a prokurorë, në një qitje të largët, dëmton jetën e shoqërisë sonë, garancitë që shoqëria duhet të ketë.

Gazetari Lorenc Vangjeli: *Nëse më lejoni t'ju flisja edhe për një pushtet tjetër, të cilin ne nuk*

e zëmë në gojë, por që ekziston dhe është pushtetit të lig të traditës sonë, gjithashtu të shumë i fortë në Shqipëri. Nuk është pushtet ligë?

kushtetues por ngjan se ka peshën e një pushteti kushtetues. Dhe ky është pushteti i traditës. Nisur nga tradita që në shumë raste tek ne vazhdon të ketë reminishenca të forta komuniste bolshevike, doja t'ju përmendja një element. Në rreth 5 mijë veta që kanë probleme me sistemin e vuajtjes së dënimit, apo të qelive të paraburgimit, gati gjysma e tyre janë të paraburgosur, janë nën masën e arrestit me burg në pritje të dhënies së vendimit. Dhe atje ka edhe njerëz të cilët kanë bërë vrasje, pra krime të rënda, por ka edhe nga ata të cilët mund të jenë në paraburgim për dy cigare hashash. Po e thjeshtëzoj këtë gjë. Dhe pushteti i traditës imponon idenë që një prokuror dhe një gjykatës që të përcjell në qeli është i ndershëm. Ndërkohë që dikush tjetër, që është lënë në arrest shtëpie apo tjetër, ky duhet parë me dyshim se ka probleme. Ndërkohë, masa e arrestit me burg është një masë përjashtimore, pra është masa më e rëndë e më ekstreme. Përpara asaj ka të tjera, që nga arrest shtëpie, që nga detyrimi për paraqitje, bllokimi i pasaportës e me radhë, që i ka kodi i procedurës penale. A mendoni ju që kërkohet një revolucion në këtë pikë, pikërisht për të shembur këtë pjesë të

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Unë mendoj që ne nga jashtë nuk mund të vlerësojmë në këtë formë punën e gjyqtarëve e prokurorëve. Nuk e kemi këtë mundësi, sepse dosjen siç e sheh gjyqtari dhe prokurori nuk mund ta shikoni as ju, as unë. Pra vendim-marrjen e caktuar në një moment të caktuar të një gjyqtari a prokurori, bindjen që krijon për çështjen, provat që ai ka, vlerësimin e tyre janë çështje që nuk rregullohen as me revolucion dhe as me goditje nga jashtë. Kjo është shumë e rëndësishme të theksohet. Nuk mund të vendosim drejtësi duke i mësuar ne nga jashtë prokurorët e gjyqtarët, se si duhet të sillen. Kjo është shumë e rëndësishme. Se si vendosin gjyqtarët dhe prokurorët, kush e kontrollojnë? E kontrollojnë instanca më e lartë, gjykata e shkallës më të lartë dhe tek e fundit deri në Strasburg. Dhe ky është mekanizmi demokratik që kemi zgjedhur. Dhe nëse ne nuk arrijmë të zbatojmë këtë mekanizëm, unë mendoj që do endemi gjithmonë në këtë pikë, në pjesën "duhet të dali, nuk duhet të dali". Unë nuk dua të vazhdoj këtë moment por padyshim ka edhe kundërpërgjigje për këtë, sepse ka njerëz të tjerë që janë në burg dhe

"Nuk mund të vendosim drejtësi duke i mësuar ne nga jashtë prokurorët e gjyqtarët, se si duhet të sillen. Kjo është shumë e rëndësishme. Se si vendosin gjyqtarët dhe prokurorët, kush e kontrollojnë? E kontrollojnë instanca më e lartë, gjykata e shkallës më të lartë dhe tek e fundit deri në Strasburg. Dhe ky është mekanizmi demokratik që kemi zgjedhur".

nuk po thotë njeri që të lirohen nga burgju, se s'ka kërkesa që të lirohen edhe ata të tjerët nga burgju. Pra, si me thënë, është një lojë që nuk mbaron asnjëherë. Dhe për këtë arsye kushtetuta ka vendosur mekanizmat, që puna e tyre kontrollohet jo nga jashtë, por nëpërmjet instancave të epërme.

Gazetari Lorenc Vangjeli: *Unë e di që përgjigja juaj është e saktë, por ndihem sërish i dëshpëruar sepse ka një ndërveprim, domethënë demokracia është kushti i vetëm dhe themelori që të ekzistojë sistemi gjyqësor i pavarur, por nga ana tjetër një sistem gjyqësor i pavarur është kusht për ekzistencën e demokracisë. Ndoshta po kërkon të na thoni së kërkohet kohë për përsosjen e të dyjave dhe paralelisht?*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Gjërat nuk ndodhin brenda natës, nuk ndodhin as brenda 5 viteve, gjërat për të cilat po flasim. Është e vërtetë ajo që thotë që nuk mund të ketë demokraci funksionale në qoftë se nuk ka pavarësi të sistemit gjyqësor, pra pavarësi të këtij sistemi që garanton balancat në shoqëri, dënimin e shkeljeve që mund të kryejë pushteti ekzekutiv apo pushteti legjislativ në raport me qytetarët e vet. Është pushteti gjyqësor ai që duhet të garantojë, që duhet të jetë i pavarur për të dënuar këto shkelje që kryhen. Por nga ana tjetër nuk mund të kemi pavarësi të sistemit gjyqësor, nuk mund të kemi gjyqtarë dhe prokurorë të pavarur në qoftë se ne nuk kemi demokraci, nuk kultivojmë mjedisin demokratik dhe stabël dhe të qetë që gjyqtarët dhe prokurorët të japin vendime të drejta, të paanshme dhe të pavarura. Nëse ne e bëjmë agresiv ambientin rreth gjyqtarëve e prokurorëve, kjo jo për të lehtësuar shkeljet e tyre, duhet të kuptohemi në këtë pjesë, që ajo që ngremë në mënyrë parimore është që t'i shërbejë shoqërisë dhe jo

një gjyqtari të caktuar. Prandaj dua ta nënvizoj se kjo që po them shkon nga ana tjetër, me filozofinë time që Inspektori i Lartë i Drejtësisë, jo vetëm që nuk është çekan mbi kokat e gjyqtarëve e prokurorëve, por do rrijë dhe do evidentojë çdo shkelje që gjyqtarët e prokurorët kanë kryer në Shqipëri dhe prandaj e përmenda edhe më parë, që janë proceduar gjyqtarë e prokurorë edhe për shkelje të kryera para 5 viteve, brenda 5 viteve natyrisht, pikërisht për të hequr imazhin e kulturës së pandëshkueshmërisë. Por nga ana tjetër, ajo që diskutojmë është çështja parimore se si ta bëjmë sa më funksionale këtë reformë në drejtësi? Si ta bëjmë sa më funksional këtë sistem drejtësie? Si ta bëjmë këtë shoqëri më të qetë demokratikisht?

Gazetari Lorenc Vangjeli: *T'ju thosha edhe diçka dmth. Një nga elementët më thelbësorë të depresionit, unë së paku gjykoj kështu, që ka shoqëria shqiptare është edhe pandëshkueshmëria e trashëguar në vite. Çfarë mesazhi mund t'i jepni ju një shumice, nuk di të them se në çfarë përqindje është, por ku përfshihen pesimistë, cinikë, të dëshpëruar për gjendjen e sistemit dhe fatin e demokracisë në përgjithësi, nisur edhe njëherë nga kjo aksiomë që ju thotë? Për sistemin e drejtësisë?*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Padyshim për sistemin e drejtësisë por unë do doja të evidentoja vetëm institucionin që përfaqësoj, sepse kjo është një pyetje e gjerë. Është delikate, jo delikate për përgjigjen që duhet dhënë, por delikate sepse padyshim shoqëria ka pritshmëritë e veta, me të drejtë. Padyshim shoqëria është e pakënaqur me sistemin gjyqësor sepse minimalisht nuk merr në kohë përgjigje për çështjet e veta, sepse ka ngarkesë të çështjeve që kanë gjyqtarët e prokurorët. Ajo që dua të theksoj unë është se ne

"Ne kemi proceduar gjyqtarë e prokurorë për shkak të zgjatjes së procedurave në mënyrë abuzuese, siç kemi arkivuar ankesa edhe për ndonjë kalim afati që kanë bërë gjyqtarë e prokurorë, por ka qenë e balancuar me ngarkesën e punës që gjyqtarët e prokurorët kanë. Kjo është detyra e institucioneve që ne kemi, për të gjetur këto balanca sepse i shërbejnë më shumë drejtësisë dhe jo debatit të momentit apo nxehtësisë së debatit të momentit. Kjo është një sfidë që duhet ta kalojmë jo thjesht ne organet e drejtësisë, por kjo është një sfidë që duhet ta kalojmë të tërë si shoqëri".

po përpiqemi shumë, që edhe të godasim gjyqtarë e prokurorë, që në mënyrë të padrejtë zgjasin procedurat ligjore, por nga ana tjetër duhet të balancojmë edhe ngarkesën e punës që ata kanë, sepse duke i kërkuar shpejtësi gjyqtarëve e prokurorëve, kalojmë nga ana tjetër, që shpeshherë vendimet gjyqësore mund të demonstrojnë edhe gabime të rënda, që vijnë për shkak të këtij nxitimi. Gjetja e kësaj balance është padyshim detyrë e institucioneve tona dhe ne këtë po bëjmë. Ne kemi proceduar gjyqtarë e prokurorë për shkak të zgjatjes së procedurave në mënyrë abuzuese, siç kemi arkivuar ankesa edhe për ndonjë kalim afati që kanë bërë gjyqtarë e prokurorë, por ka qenë e balancuar me ngarkesën e punës që gjyqtarët e prokurorët kanë. Kjo është detyra e institucioneve që ne kemi, për të gjetur këto balanca sepse i shërbejnë më shumë drejtësisë dhe jo debatit të momentit apo nxehtësisë së debatit të momentit. Kjo është një sfidë që duhet ta kalojmë jo thjesht ne organet e drejtësisë, por kjo është një sfidë që duhet ta kalojmë të tërë si shoqëri. Unë e kuptoj që kjo mund të duket zhgënjyese në radhë të parë, mund të duket edhe si filozofi, sepse njerëzit mund të thonë,

– s'të kemi zgjedhur për këtë çështje, vazhdo punën, – por ajo që po them, institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj e theksova tek vetja, i ka shërbyer ankesave të qytetarëve në maksimumin e vet, i ka shërbyer interesit të sistemit të drejtësisë në maksimumin e vet. Jo më kot e përmenda numrin e madh të gjyqtarëve të hetuar, jo më kot e përmenda numrin e madh të gjyqtarëve të proceduar, të prokurorëve të proceduar, jo më kot e përmenda gjithashtu si standard pune edhe procedurat që ka ndjekur Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të cilat janë konfirmuar si nga Këshillat, si nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Këto janë frytet e para të punës, që natyrisht premtojnë për më shumë në të ardhmen, por efektet e këtyre standardeve nuk mund të duken sot.

Gazetari Denis Minga: Z. Metani ju falenderoj për këtë intervistë, duke ju uruar suksese në vazhdimin e misionit tuaj!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Faleminderit edhe juve për ftesën dhe pyetjet.

JANAR 2023

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.


© ILD

**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko](#) për të ndjekur spotin prezantues të ILD